



UNMIK/REG/2005/29
31 maj 2005

RREGULLORE NR. 2005/29

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR INSPEKTIMIN E TREGUT
TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 8 prill 2005 lidhur me Ligjin mbi inspektimin e tregut të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 mars 2005,

Duke vënë re se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi inspektimin e tregut (Ligji nr. 02/L-1) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në ditën e nënshkrimit, me kusht që:

(a) Në nenin 2, shprehja “organizata për licencim” të ndryshohet në “autoriteti për licencim”;

(b) Në nenin 19, paragrafi 1, fjalët “masat ndëshkuese” të zëvendësohen me “sanksionet administrative”;

(c) Në nenin 20, fjala “gjobitje” të ndryshohet në “sanksion administrativ”;

(d) Titulli i kapitullit IV “Dispozitat ndëshkuese” të zëvendësohet me “Sanksionet administrative”;

(e) Në nenet 31 dhe 32, fjala “i ndëshkuar” të zëvendësohet me “i sanksionuar”, dhe fjala “dënim” të zëvendësohet me “gjobë”;

(f) I tërë neni 32 fshihet dhe zëvendësohet si vijon: “Personi juridik sanksionohet në mënyrë administrative me një gjobë prej 250 eurosh deri në 1.000 euro kur nuk i dorëzon ose nuk i përgatit të dhënat e kërkuara nga inspektori ose kur dorëzon të dhëna ose raporte të pasakta, në pajtim me nenin 13”;

(g) Në nenin 33, fjala “buxhet” të zëvendësohet me “fond”;

(h) Në nenin 36, pas fjalës “mbikëqyrës” të shtohet fjala “treg” dhe

(i) Në tërë tekstin e ligjit “Kosova” të zëvendësohet me “Kosovo” (në anglisht).

Këto ndryshime pasqyrohen në tekstin përfundimtar zyrtar të ligjit.

Nënshkruar sot, më 31 maj 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm